

LIGJ
Nr.8361, datë 1.7.1998

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.7602, DATË 9.9.1992 "PËR GARDËN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7602, datë 9.9.1992 "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", në nenin 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Garda e Republikës kryen shërbimin e brendshëm parlamentar në mënyrën dhe në rastet e përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë dhe të akteve të dala në zbatim të saj. Personeli i shërbimit të brendshëm parlamentar është i përhershëm. Pjesëtarët e shërbimit të përhershëm parlamentar mund të shkarkohen ose të lëvizën në detyra të tjera vetëm në rastet e parashikuara në ligj dhe në aktet e tjera që rregullojnë veprimtarinë e shërbimit të brendshëm parlamentar.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2147, datë 9.7.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani